



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Botimi 5

## **BULETINI**

### **I**

## **UDHËZIMEVE TEKNIKE NR. 5**

(Janar – Qershor 2019)



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

TABELA PËRMBLEDHËSE

1. **HYRJE**.....
2. **UDHËZIME TEKNIKE**.....
  - 2.1. *Sqaruese për zbatimin sa më korrekt të VKM-së Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 “Për TVSH-në në RSH”, i ndryshuar, lidhur me zgjedhjen dhe aplikimin e TVSH-së në ndërtim.*
  - 2.2. *Sqarim lidhur me procedurën që duhet të ndjekin tatimpaguesit të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e tregimit të inpleteve dhe makinave bujqësore.*
  - 2.3. *Mbi procedurat e regjistrimit të fitimit të pronësisë, së pasurive të paluajtëshme të konfiskuara.*
3. **RASTE SPECIFIKE TË TATIMPAGUESVE TË TRAJTUARA PËR PROBLEME TË HASURA NË PRAKTIKË**.....
  - 3.1 **Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar**
    - 3.1.1 *Trajtimi nga pikëpamja fiskale për mënyrën e faturimit të shërbimit që ofrohet nga ndërmjetësi*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### I. HYRJE

Marrëdhëniet ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve rregullohen nëpërmjet dispozitave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tyre. Këto dispozita saktësojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar. Vlen të theksohet se, prioritet i administratës tatimore është trajtimi i njëjtë dhe në mënyrë të barabartë i të gjithë tatimpaguesve dhe respektimi korrekt dhe i njëjtë i dispozitave ligjore nga ana e tyre.

Në zbatim të Nenit 10, pika 3 e ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në funksion të marrëdhënies së vazhdueshme administratë tatimore – tatimpagues, si dhe e udhëhequr nga parimet e administrimit tatimor të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, publikon Buletinin Nr.4, në të cilin janë përfshirë sqaruese/orientuese dhe trajtime për raste specifike të adresuara në administratën tatimore nga tatimpagues të ndryshëm që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Ky Buletin vjen si vazhdimësi e Buletineve të mëparshëm të publikuara në ëbsite-in e administratës tatimore, në të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të detyrave të saj funksionale dhe në trajtim të dhjetëra shkresave dhe kërkesave të tatimpaguesve apo edhe të strukturave të saj të varësisë, ka përmbledhur raste specifike, të cilat mund të shërbejnë si referencë për tatimpagues të ndryshëm në trajtimin e një sërë problemesh që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit tatimor, me procedurat tatimore apo edhe me çështje dhe raste praktike.

Referuar sa më sipër, ky Buletin, është një përmbledhje e sqarimeve, opinioneve dhe udhëzimeve, që kanë unifikuar qasjen e administratës tatimore kundrejt tatimpaguesve dhe përfshin periudhën nga 1 Janar 2019 deri më 30 Qershor 2019.

Ky Buletin në logjikën e buletineve të mëparshëm është i organizuar në 3 kapituj, të cilët respektivisht janë ndarë në kapitullin hyrës, në kapitullin II, në të cilin përfshihet një sqaruese/orientuese që u drejtohet Drejtorive Rajonale, me qëllim sqarimin e procedurave në lidhje me regjistrimin apo çregjistrimin nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së për OJF-të dhe



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

unifikimin e veprimeve dhe qëndrimeve për trajtimin e këtyre të fundit. Si dhe një sqaruese në nëndarjen e dytë për Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambjentet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar edhe kapitulli III, i cili përban një trajtim nga pikëpamja fiskale e huapërdorjes për sendet e luajtshme.

### I. UDHËZIME TEKNIKE

#### *2.1. Sqaruese mbi zbatimin e TVSH-së në ndërtim.*

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2019

Lënda: Sqaruese për zbatimin sa më korrekt të VKM-së Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 “Për TVSH-në RSH”, i ndryshuar, lidhur me zgjedhjen dhe aplikimin e TVSH-së në ndërtim

#### **1. Ndarja e përgjegjësisë tatimore midis ndërtuesit/investitorit dhe pronarit të tokës.**

Lidhur me përgjegjësitë tatimore si për investitorin ashtu dhe për ndërtuesin, duhet të mbahet parasysh që ndërtimi duhet parë i ndarë në faza, ku secila fazë trajtohet më vete për qëllime të TVSH-së.

Për vetë specifikën që paraqet veprimtaria e ndërtimit, sidomos në rastet e vetëfurnizimeve në ndërtim, ku ndërtimi i objektit (situacionimi dhe faturimi i punimeve) shtrihet për një periudhë kohe më të gjatë se një periudhë tatimore dhe zbritja e TVSH-së kryhet në momentin e përcaktuar me ligj, ndërsa përfundimi i punimeve (që ka të bëjë me momentin e fillimit të përdorimit të objektit), ndodh në një moment tjetër të ndryshëm nga momenti i lindjes së zbritshmërisë të TVSH-së, është kusht i domosdoshëm që lloji, natyra dhe qëllimi i përdorimit të objektit të shpallet dhe aprovohet në lejen e ndërtimit të dhënë sipas legjisllacionit të fushës në fuqi.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në çdo rast, përsa i përket ndërtimit, rregullat për qëllime të TVSH-së, përcaktohen për të rregulluar dhe sqaruar zbatimin e tatimit për një veprimtari të kryer bazuar në legjislacionin e fushës ku ushtrohet veprimtaria duke siguruar në çdo moment që çdo operacion, transaksion, furnizim, është kryer në përputhje me lejet, licencat, kërkesat, kriteret, etj., të kërkuara sipas legjislacionit të fushës.

Inspektorët e DRT gjatë kontrolleve që ushtrojnë në këto shoqëri përpara fillimit të kontrollit duhet që të kenë parasysh:

- Në çdo rast, të përcaktojnë të dhënat për ndërtuesin dhe investitorin, të dhënat për llojin e objektit, natyrën dhe qëllimin e përdorimit të tyre referuar lejes së ndërtimit, kusht ky i rëndësishëm lidhur me zbritjen e TVSH-së ;
- Kur përdorimi i objektit është furnizim i përzier, të përcaktohet qartë bazuar në planimetrinë e objektit pjesët përkatëse dhe qëllimi i përdorimit të tyre;
- Që në fillim të kontrollit duhet të përcaktohen sipërfaqet për të cilat përfitohet kreditimi i TVSH-së.

Bazuar edhe në referencat sqaruese të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.6, datë 30.01.2015, “Për TVSH-në”, i ndryshuar, procesi i ndërtimit është furnizim shërbimi i tatueshëm me TVSH.

Kujdes! Përftimi i ndërtesës dhe furnizimi i mëpasshëm i saj konsiderohet furnizim malli. Në këtë rast, për investitorin, inspektorët e kontrollit duhet të verifikojnë zbatimin e Udhëzimit të Përbashkët Nr. 29 datë 30.07.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtëshme”, për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me kalimin e pronësisë.

Rastet e hasura në praktikë:

- Nëse objekti që ndërtohet është i destinuar të përdoret për *veprimtari të tatueshme*, e evidentuar kjo në lejen e ndërtimit, personi i tatueshëm që kryen ndërtimin (sipërmarrësi), që është kontraktuar nga investitori, ka të drejtë të kreditojë plotësisht TVSH-në lidhur me blerjet e kryera brenda vendit apo të importuara që lidhen me atë ndërtim. Gjithashtu, investitori ka të drejtën e kreditimit të TVSH-së së faturuar, nga sipërmarrësi i punimeve.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

- Nëse objekti që ndërtohet është i destinuar të përdoret për *veprimtari të përjashtuar*, evidentuar kjo në lejen e ndërtimit, personi i tatueshëm që kryen ndërtimin (sipërmarrësi), që është kontraktuar nga investitori, ka të drejtë të kreditojë plotësisht TVSH-në lidhur me blerjet e kryera brenda vendit apo të importura, që lidhen me atë ndërtim. Investitori në këtë rast, nuk ka të drejtën e kreditimit të TVSH-së së faturuar, nga sipërmarrësi i punimeve. Investitori i deklaron këto, si blerje të përjashtuara nga TVSH-ja.
- Kur një person i tatueshëm është njëkohësisht *ndërtues dhe investitor*, i cili ndërton një objekt për t'u shfrytëzuar nga vetë ai për kryerjen e një veprimtarie të tatueshme (jo të përjashtuar) bën blerje të nevojshme për realizimin e punimeve. Këto të fundit do t'i deklarojë si blerje me TVSH të zbritshme.
- Kur personi i tatueshëm është njëkohësisht *ndërtues dhe investitor* dhe objekti që ndërtohet është i destinuar të përdoret për *veprimtari të përjashtuar dhe veprimtari të tatueshme (i përzier)*, evidentuar kjo në lejen e ndërtimit, personi i tatueshëm që kryen ndërtimin *ndërtues dhe investitor*, ka të drejtë të kreditojë TVSH-në, të evidentuar me vete për pjesën e ndërtimit që do ti shërbejë veprimtarisë së tatueshme.

### **2. Lidhur me zbatueshmërinë e VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për TVSH-në në RSH”, i ndryshuar, për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës.**

Kur një person i tatueshëm do të ushtrojë të drejtën e qiradhënies si furnizim i tatueshëm, paraprakisht duhet të dorëzojë një deklaratë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku deklaron se qiradhënia do të trajtohet si furnizim i tatueshëm duke e pasqyruar këtë veprimtari edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

E drejta e zgjedhjes mund të ushtrohet në rastet e mëposhtme:

- i. Para përfundimit të procesit të ndërtimit dhe qiramarrësit nuk janë përcaktuar ende;
- ii. Kur është përfunduar procesi i ndërtimit dhe ndërtesa është e regjistruar në zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që japin me qira ndërtesa (ambiente) për banim kundrejt individëve.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Sipas rastit (i), kur e drejta e zgjedhjes ushtrohet që në fazën e ndërtimit të një ndërtese, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në VKM Nr.953, datë 29.12.2014, ushtrimi paraprak i së drejtës së zgjedhjes detyron qiradhënësin e ardhshëm që në mungesë të përcaktimit të qiramarrësit të ardhshëm, të përcaktojë e identifikojë në deklaratën e tij ndërtesën (ambientet) /ndërtesat të cilat do të përdoren për veprimtari qiradhënieje të tatueshme.

Gjithashtu, qiradhënësit që përveç veprimtarisë së qiradhënies ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të tatueshme me TVSH ose jo, në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së duhet t'i evidentojnë veçmas shpenzimet për secilën kategori të veprimtarisë.

Sipas rastit (ii), kërkohet hartimi i një kontrate noteriale midis qiradhënësit dhe qiramarrësit, në të cilën duhet të jetë shprehur qartë se palët bien dakord se qiradhënien do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH.

Personi i tatueshëm qiradhënës, përveç deklaratës, duhet të depozitojë edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës së qirasë nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm me TVSH.

Kur personi i tatueshëm ushtron të drejtën e zgjedhjes së aplikimit të TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës, ai duhet të aplikojë zgjedhjen për çdo rast, përjashtimisht rastit kur qiramarrësi është një person i tatueshëm që kryen veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Në këtë rast, është kusht që në kontratën e qirasë të shkruhet e shprehur qartë zgjedhja e dëshiruar nga qiradhënësi dhe pranimi i saj nga qiramarrësi.

### **3. Lidhur me zbatueshmërinë e VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në në RSH”, i ndryshuar, në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës.**

Personi i tatueshëm ushtron këtë të drejtë duke paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore një deklaratë me shkrim, ku deklaron se furnizimi i ndërtesës do të trajtohet si furnizim i tatueshëm me TVSH 20%. Kjo deklaratë, e cila formalizon qëllimin e personit të tatueshëm për të aplikuar regjimin normal të TVSH-së për furnizimin e ndërtesës, përmban të dhënat për çdo ndërtesë/ambient, të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm blerës (emri, NIPT-i adresa etj.) si dhe të dhënat mbi lejen e ndërtimit dhe qëllimin e përdorimit të ndërtesës.

Lloji i ndërtesës, natyra e saj dhe qëllimi i përdorimit përcaktohen gjithashtu në lejen e ndërtimit apo miratimet e mëvonshme të marra për zbatimin e lejes. Në rastet kur nuk është e



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

mundur të identifikohet nëse ndërtesa është shitur për qëllime banimi ose jo, atëherë leja e ndërtimit shërben si dokument justifikues dhe vërtetues për të gjykuar mbi aplikimin.

Furnizimi i ndërtesës trajtohet me TVSH, vetëm në rast se në kontratën e furnizimit, personi i tatueshëm blerës është njohur me këtë fakt dhe ka pranuar të paguajë TVSH-në. Në këtë rast, furnizuesi disponon dhe paraqet edhe kontratën përkatëse. Mungesa e kontratës nuk i jep të drejtën e trajtimit të furnizimit si të tatueshëm.

Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që furnizojnë apartamente, ndërtesa apo ambiente për banim ose kur blerësi është një individ.

E drejta e zgjedhjes ushtrohet për ndërtesat ose pjesë të ndërtesës, të cilat furnizohen (shiten) për qëllim përdorimi për veprimtarinë ekonomike të blerësit, subjekt i regjistruar, ose për qëllime rishitjeje prej tij, por jo për banim.

### *2.2. Sqaruese për Drejtorinë Rajonale Tatimore për shitjen e inuteve dhe makinave bujqësore gjendje (stok) deri më 31.12.2018*

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale Tatimore

Tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e furnizimeve të inuteve dhe makinave bujqësore, lidhur me furnizimin e mallrave stok deri në datë 31.12.2018, duhet të ndjekin procedurën si vijon:

Tatimpaguesit, të cilët kanë kryer furnizime të inuteve dhe makinave bujqësore dhe kanë paguar TVSH-në deri në datë 31.12.2018 për këto furnizime, bazuar në nenin 69 “Zbritja e TVSH -në”, pika 1 të Ligjit Nr.92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 53 “Transaksione që mundësojnë zbritjen e TVSH-së”, si dhe pika 1 e Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015, dalë në zbatim të ligjit, kanë gëzuar të drejtën e zbritjes së TVSH-së e llogaritur për transaksionet e tatueshme (inuteve dhe makinave bujqësore).



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në nenin 51 “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm”, të Ligjit Nr.92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikat “n” dhe “nj”, është përcaktuar se, prej datës 01.01.2019 furnizimet e inpleteve (plehra kimike, pesticide, fara dhe fidanë) dhe makinave bujqësore sipas listës së miratuar me VKM Nr. 953, datë 29.12.2014, janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Për inputet dhe makinat bujqësore të importuara apo të blera në vend, tatimpaguesit që rezultojnë me gjëndje malli (stok) për të cilën është paguar TVSH-ja në blerje, deri në datë 31.12.2018 duhet të kenë në vendin ku ushtrojnë aktivitetin e tyre, inventarin e stokut të dokumentuar në mënyrë analitike. Drejtoritë Rajonale Tatimore duhet të kontrollojnë saktësinë e inventarëve të dorëzuar nga tatimpaguesit, me qëllim saktësimin e gjëndjes së mallit ( inpleteve dhe makinave bujqësore), deri më datë 31.12.2018.

Meqënëse, për furnizimin e inpleteve dhe makinave bujqësore, ka ndodhur kalimi nga një furnizim i tatueshëm i tij, me të drejtë të zbritjes së TVSH-së, në një furnizim të përjashtuar pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së, sipas ndryshimeve ligjore, të gjithë tatimpaguesit që kryejnë këto furnizime, duhet të kryejnë rregullimin e TVSH-së së zbritshme, në formularin e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së, i cili ka rubrikë të posaçme për rregullimin e TVSH-së së zbritshme (rubrika 50-51).

Furnizimet (shitjet) e realizuara gjatë vitit 2019, që i përkasin furnizimeve (gjëndje stoku) të kryera gjatë vitit 2018 do të shiten duke mos llogaritur TVSH-në.

### *2.3 Mbi procedurat e regjistrimit të fitimit të pronësisë, së pasurive të paluajhtëshme të konfiskuara.*

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2019

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale Tatimore

Lënda: Sqarim lidhur me procedurën që duhet të ndjekin tatimpaguesit te cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e tregimit të inpleteve dhe makinave bujqësore.

Në Fletoren Zyrtare Nr. 28, datë 06.03.2019, është publikuar ligji Nr. 111/2018, "Për Kadastrën", i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit. Në nenin 47/1, të tij, ky ligj parashikon



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

shprehimisht se, *regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, bëhet nga drejtoria vendore, pas përgatitjes së këtyre akteve, sipas procedurës së parashikuar në nenet 24 dhe 25, të këtij ligji, dhe plotësimit të kushteve të regjistrimit, të parashikuara në nenin 193 të Kodit Civil.*

Marrë në konsideratë parashikimet sa me sipër, si dhe dispozitat e Kreut XI, nenet 88 e vijues, të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, lidhur me procedurat ligjore për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor të papaguar, çdo Drejtori Rajonale të marrë masat që, për pasuritë e paluajtshme të identifikuar të tatimpaguesve debitorë, për të cilat ka nxjerrë Urdhër Sekuestrimi sipas neneve 93 dhe 94, të ligjit të sipërcituar dhe detyrimi tatimor sërish nuk është shlyer i plotë, të nxjerrë aktin për konfiskimin e pasurisë së sekuestruar dhe të kërkojë pranë Drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të bëjnë regjistrimin e fitimit të pronësisë në bazë të akteve administrative të sipërcituara.

Në rast refuzimi të këtij regjistrimi, nga ana juaj duhet të ndiqen hapat gjyqësore, bazuar edhe në parashikimet konkrete të pikës 3, të nenit 47, të ligjit Nr. 111/2018, "Për Kadastrën". Pas regjistrimit të fitimit të pronësisë, do të vijohet me procedurat pasuese të shitjes së pasurive të konfiskuara në ankand, sipas parashikimeve të nenit 96, të ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar dhe dispozitave procedurale të ligjit për ankandin publik.

### III. RASTE SPECIFIKE TË TATIMPAGUESVE TË TRAJTUARA PËR PROBLEMATIKA TË HASURA NË PRAKTIKË

#### 3 Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

*3.1.1 Trajtimi nga pikëpamja fiskale për mënyrën e faturimit të shërbimit që ofrohet nga ndërmjetësi*

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2018

Lënda: Kthim përgjigje



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në përgjigje të shkresës Nr \_\_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_\_ me lëndë “Kërkesë për interpretim”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr. \_\_\_\_\_, Prot., datë \_\_\_\_\_, informojmë si më poshtë:

Qarkullimi i një tatimpaguesi për qëllime të TVSH-së sikurse përcakohet në nenin 119 të Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është citojmë: “*Qarkullimi përfshin qarkullimin e realizuar nga të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve, përfshirë furnizimet e kryera sipas neneve 57, 59, 60, 61 dhe 62, të këtij ligji, të kryera nga i njëjti person i tatueshëm, dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi, pa përfshirë TVSH-në*”.

Ndërkohë, në Nenin 19 të Udhëzimit Nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, është përcaktuar trajtimi fiskal i transaksioneve të ndërmjetësit që vepron në emër të një personi tjetër si dhe kushtet kontraktuale dhe transaksionet që duhet të ndodhin mes palëve si furnizues shërbimi, ndërmjetës dhe klientit.

Në rolin e ndërmjetësit transparent, ndërmjetësi në emër dhe për llogari të një personi tjetër mund të kontraktojë personalisht me një të tretë në rastet kur:

a) Kontrata noteriale shpreh qartë se ai (ndërmjetësi) nuk vepron në emër të tij, por vepron në emër dhe për llogari të një personi tjetër dhe kushti plotësohet vetëm nëse në kontratë shkruhet emri, identiteti, adresa, si dhe NIPT-i i klientit, për të cilin parashikohet ndërmjetësimi.

b) Fatura për një furnizim në këto raste lëshohet drejtpërdrejtë nga klienti për të tretin (ndërmjetësimi për shitjen) apo i adresohet drejtpërdrejtë klientit nga i treti (ndërmjetësimi për blerje) dhe ndërmjetësi faturon vetëm komisionin e ndërmjetësimit.

Udhëzimi lidhur me qarkullimin saktëson se:

1. Në rastin kur, në rolin e ndërmjetësit transparent, furnizimi kryesor faturohet nga vetë furnizuesi i mallit ose shërbimit për blerësin dhe ndërmjetësi i faturon vetëm komisionin klientit të tij, atëherë qarkullimi vjetor për qëllime të kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në është vlera totale e komisioneve të përftuara.

2. Në rastin kur, në rolin e ndërmjetësit transparent, ndërmjetësi në emër të furnizuesit kryesor (klientit) sipas kontratës me të, faturon furnizimin e shërbimit ose furnizimin e mallit në rolin e furnizuesit duke e bërë transparent faktin se në emër të cilit vepron, atëherë qarkullimi vjetor për qëllime të kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që paguan blerësi për vlerën e furnizimit, pa përfshirë TVSH-në.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Qarkullimi për çdo tatimpagues/agjenci ndërmjetësimi, përcaktohet nga mënyra se si ndodhin dhe dokumentohen transaksionet midis agjencisë dhe furnizuesit kryesor, furnizuesit kryesor-klientit përfundimtar dhe agjenci – klient përfundimtar.